



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e III-të
Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion;

Mbledhja nr.17/2008;
Më 22.07.2008, në ora 11:00;
Ndërtesa e Kuvendit, Salla C-203;

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Et'hem Çeku, Haki Shatri, Fatmir Rexhepi, Berim Ramosaj, Zef Morina, Safete Hadergjonaj dhe Mufëra Şinik;

Munguan: Slobodan Petroviq, Sala Berisha – Shala, ndërsa më arsye mungoj Kaqusha Jashari;

Përcjellës prezent: Hakif Jashari (Departamenti Ligjor në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë), Ibush Luzha (Përgjegjës i Njesisë së Akreditimit), Lumnije Berisha nga Presidenca dhe Blerina Uka nga NDI;

Nga zyra mbështetëse: Hasan Tahiri, Armend Ademaj dhe Besim Haliti;

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani – Kryetare e Komisionit;

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara (08 dhe 11 korrik 2008);
3. Shqyrtimi i raportit me rekomandim për Ligjin për Ngrohje qendrore Nr.02/L-49;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Akreditim Nr. 02/L-43;
5. Të ndryshme;

I. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

II. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara (08 dhe 11 korrik 2008);

Procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit të datës 08 dhe 11 korrik u miratuan pa vërejtje.

III. Shqyrtimi i raportit me rekomandim për Ligjin për Ngrohje qendrore Nr.02/L-49;

Kryetarja – kërkoj nga anëtarët e Komisionit, ndonjë vërejtje apo ndërhyrje në Raportin me rekomandime për Ligjin për Ngrohje qendrore Nr.02/L-49.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit, kryesusja konstatoi se unanimisht, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- I. Komisioni miratohet Raportin me rekomandime për Ligjin për Ngrohje qendrore Nr.02/L-49;
- II. Autorizohet stafi mbështetës që të procedoj këtë Raport për miratim në seancë plenare;

IV. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Akreditim Nr. 02/L-43;

Kryetarja – kërkoj nga Grupi punues që të paraqes amendamentet e nxjerra nga takimet që kanë realizuar.

Haki Shatri – theksoj se Grupi punues i përberë nga Haki Shatri kryetar, Zef Morina dhe Sala Berisha –Shala anëtarë, e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për Akreditim Nr. 02/L-43, në dy mbledhje, gjegjësisht më datë 11.07.2008 dhe 22.07.2008, dhe prezentoj amendamentet e miratuara në Grup, të paraqitura në vijim:

Amendamenti 1

Preambula harmonizohet dhe plotësohet;

Arsyetim:

Grupi punues e arsyetoj më faktin se preambula duhet të harmonizohet më Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sepse projektligji thirret në Kornizën Kushtetuese, ndërsa preambulës i mungon rezymeja përmbajtjesore.

Unanimisht mbështetët nga Komisioni;

Amendamenti 2

Ndryshohet titulli: Projektligjit për ndryshimin e ligjit për akreditimin” si vijon:
“Projektligji për akreditim”

Arsyetim:

Projektligji quhet “Projektligji për ndryshimin e Ligjit për Akreditim Nr. 02/L-43”, ndërsa në nenin 14, tek dispozitat kalimtare thuhet: “më hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji Nr. 02/L-43 për Akreditim.”. Kështu që kur ky projektligj po ndryshon ligjin në fuqi, ndërkohë ai ligj po shfuqizohet atëherë është e pakuptim, që ky projektligj të mbetet më këtë titull.

Unanimisht mbështetët nga Komisioni;

Amendamenti 3

Neni 1 ndryshohet si vijon:

Me këtë Ligj themelohet Drejtoria për akreditim si dhe përcaktohen rregullat e funksionimit të sistemit për akreditim të organit kompetent për vlerësim të konformitetit.

Arsyetim

“politikat” nuk përcaktohen më ligj por inkorporohen dhe zbatohen përmes ligjit kështu që përfshirja e kësaj shprehje është edhe në kundërshtim me kërkesat për standardizim të legjisllacionit.

Unanimisht mbështetët nga Komisioni;

Amendamenti 4

Fjala: “organizëm” zëvendësohet me fjalën: “organ” në tërë tekstin e Projektligjit.

Arsyetim:

Grupi punues konstatoi se fjala “organizëm” është e pakuptimit të jetë në një Ligj, sepse përcakton diçka biologjike. Kështu që poenta e hartuesit vërehet të ketë qenë për fjalën: “organin” e autorizuar.

Unanimisht mbështetët nga Komisioni;

Amendamenti 5

Neni 2 Riformulohet dhe plotësohet.

Arsyetim:

Grupi punues konstatoi se Neni 2 “përkufizimet”, kanë nevojë për riformulime të tërësishme sepse ka mjaft paqartësi dhe kontradikta. Kështu që është autorizuar stafi mbështetës që në bashkëpunim me zyrën ligjore të MTI dhe njësinë për lektorim të riformulojë përkufizimet në pajtim me qëllimin e tyre e të dispozitave të Projektligjit.

Unanimisht mbështetët nga Komisioni;

Amendamenti 6

Neni 3 Ndryshohet si vijon: Drejtoria për Akreditim

3.1 Në kuadër të MTI-së themelohet Drejtoria e Akreditimit si i vetmi subjekt kombëtar i pavarur akreditues në Kosovë, për kryerjen e akreditimit të organit për vlerësim të konformitetit.

3.2 Drejtoria e Akreditimit ka emblemën e vetë e cila mbrohet me ligj.

3.3 Në kuadër të Drejtorisë së Akreditimit formohet këshilli i akreditimit i cili përfaqëson interesat e palëve në fushën e akreditimit.

3.4 Ministri i MTI-së nxjerr aktet nënligjore për organizimin dhe për funksionimin e Drejtorisë së Akreditimit.

Arsyetim:

Paragrafi 1 i Nenit 3 është riformuluar sepse në gjendjen në të cilën ishte i hartuar, paraqiteshin mjaft paqartësi dhe konfuzitet.

Neni 3.3 zhvendoset në vend të paragrafit 3.5 që behet 3.4 ndërsa paragrafi 3.5, hiqet sepse është përfshirë me paragrafin 3.4

Arsyetim:

Grupi punues konstatoi se këto dy paragrafë nuk janë të vendosura në vendin e duhur sepse në paragrafin 3.5 thuhet ajo që është thënë në paragrafin 3.3 Andaj sipas traditës juridike të hartimit të Ligjeve zakonisht paragrafi që autorizon subjektin për nxjerrjen e akteve nën ligjore vendoset si paragraf i fundit .

Unanimisht mbështetet nga Komisioni;

Amendamenti 7

Neni 4 Ndryshohet si vijon:

Neni 4

4.1 Drejtorinë për Akreditim e udhëheq drejtori që është nëpunës civil.

4.2 Drejtoria ka kompetencë dhe përgjegjësi për nxjerrjen e vendimit për akreditim.

Paragrafi 2 fshihet.

Arsyetim:

Grupi punues konstatoi se titulli “statusi” është i panevojshëm. Neni 4.1 zërthehet në dy paragraf më të qarta kurse paragrafi ekzistues 4.2 hiqet sepse flet për statusin juridik dhe detyrat e nëpunësve civil e që rregullohen me akte tjera për shërbyesit civil.

Unanimisht mbështetet nga Komisioni

Amendamenti 8

Neni 6 Ndryshohet: titulli dhe paragrafi: i) si vijon: Detyrat e Drejtorisë së Akreditimit

Arsyetim:

Konstatimi i Grupit punues ishte se ky titull fletë për përgjegjësi ndërsa dispozitat flasin për detyra-autorizime shtesë. Nisur nga përmbajtja e dispozitave titulli duhet të jetë detyrat e Drejtorisë e jo përgjegjësit.

Drejtoria e Akreditimit veç tjerash ka edhe këto detyra:

i) Përfaqëson Republikën e Kosovës në organizatat ndërkombëtare të akreditimit.

Arsyetim: hiqet fjala “evropiane” sepse me shprehjen “ndërkombëtar” nënkupton edhe subjektet evropiane.

Unanimisht mbështetët nga Komisioni

Amendamenti 9

Neni 7 Ndryshohet titulli si vijon: PROCEDURAT DHE TARIFAT E AKREDITIMIT

Arsyetim: fjalët: “Bazat dhe Parimet” hiqen nga titulli sipas standardeve legislative nuk mund të vendosen në kuadër të dispozitave themelore. Nëse duhet të përfshihen, të njëjtat mund të përfshihen në pjesën e përgjithshme.

Neni 7 bartet pas nenit 2 dhe ndryshohet si vijon

“Veprimtaria e akreditimit në Kosovë bazohet në këtë ligj dhe në standardet e BE-së apo ndërkombëtare për akreditim.”

Arsyetim: Përmbajtja e kësaj dispozite është e përsëritur edhe me norma tjera andaj kjo dispozite mund të vendoset në pjesën normative të përgjithshme.

Unanimisht mbështetët nga Komisioni;

Amendamenti 10

Neni 8 bartet para nenit 3; Parimet e akreditimit

Akreditimi është vullnetar dhe bazohet në parimet si vijon:

- a) paanshmëria;
- b) transparenca;
- c) kompetenca profesionale;
- d) ruajtja e konfencialitetit;
- e) përrputhshmëria me rregullat dhe me procedurat e akreditimit në Evropë dhe në nivel ndërkombëtar.

Arsyetim:

Parimet nuk paraqesin dispozita themelore andaj nëse duhet të përfshihen në ligj ato duhet të radhiten në kuadër të normave të përgjithshme.

Unanimisht mbështetët nga Komisioni;

Amendamenti 11

Neni 9 Ndryshohet paragrafi 1 si dhe paragrafët 9.8; 9.9;9.10; 9.12 dhe 9.13 barten në kuadër të nenit 10, në pjesën e parë të nenit.

Arsyetim:

Grupi punues konstatoi se këto paragrafe nuk përkojnë më nenin 9 dhe nuk paraqesin qëllimin e këtij neni sepse janë pjesë e masave administrative të cilat i ndërmerr autoriteti administrativ e që do duhet të radhiteshin në kuadër të dispozitave për procedura ankimore.

Unanimisht mbështetët nga Komisioni;

Amendamenti 12

Neni 10

Ndryshohet titulli, dhe në kuadër të nenit 10 nga neni 9 bartën paragrafët (9.8; 9.9;9.10; 9.12) si vijon:Masat administrative dhe procedurat ankimore.

Arsyetim: ky nen është shtuar edhe me paragrafët që kanë të bëjnë me masat administrative që i ndërmerr autoriteti kompetent për shkak të shkeljeve administrative. Është e preferueshme që në kuadër të këtyre rregullave pas shkeljeve pason edhe procedura ankimore e cila për zbatuesin është më e lehtë dhe më efektive nëse sistemohen sipas natyrës juridike.

Unanimisht mbështetët nga Komisioni;

Amendamenti 13

Neni 13 Ndryshohet si vijon:Dispozitat ndëshkimore

13.1 Organi i akredituar ose i pa akredituar që keqpërdor emblemën e akreditimit, benë kundërvajtje e që dënohet me gjobë si vijon:

- a) laboratorit testues apo kalibrues në shumë prej 5000€;
- b) organi certifikues në shumë prej 10000€
- c) organi inspektues në shumë prej 15000€.

13.2 Mjetet financiare të inkasuara nga dënimet me gjobë për kundërvajtje, derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës.

Arsyetim: vepra e dënueshme duhet gjithsesi të kualifikohet në të kundërtën nuk mund të shqiptohet masa ndëshkimore sepse me mos kualifikimin e veprës nuk dihet as organi para të cilit zhvillohet procedura përkatëse.

Unanimisht mbështetët nga Komisioni;

Amendamenti 14

Neni 15 Ndryshohet si vijon:

15.1 Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të gjitha përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet e njësisë së akreditimit i kalojnë drejtorisë së akreditimit. Të gjithë punonjësit e njësisë së akreditimit kalojnë si punonjës të drejtorisë së akreditimit.

15.2 Certifikatat e lëshuara nga njësia e akreditimit njihen nga drejtoria e akreditimit dhe kanë të njëjtën vlefshmëri.

15.3 Procedurat e akreditimit të filluara në përputhje me Ligjin Nr. 02/L-43, datë 21.11.2005, për akreditimin e laboratorëve testues, kalibrues dhe organizmave certifikues, inspektues në Kosovë, kryhen në përputhje me këtë ligj.

Arsyetim:

nenit 15.3 i hiqet pjesa tjetër e fjalisë (pjesa e fundit) sepse nëse mbeten në fuqi aktet tjera nënligjore që kanë dal nga Ligji për akreditim në fuqi, krijohen kolizion e që krijohen konflikte gjatë zbatimit. Aktet nënligjore shfuqizohen vetvetiu me vetë faktin që shfuqizohet Ligji në fuqi.

15.4 Për zbatimin e këtij Ligji, Ministra e Tregtisë dhe Industrisë nxjerr akte nënligjore në afat prej (6) gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi.

Arsyetim:

Paragrafi 4 është kërkesës e pa shmangshme që detyrat e njëkohshme të afatizohen në të kundërtën nuk mund të kërkohej përgjegjësi nga kompetentët.

Unanimisht mbështetet nga Komisioni;

Amendamenti 15

Neni 16 Ndryshohet si vijon: Hyrja në fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Arsyetim:

Hyrja në fuqi e ligjit behet vetëm në pajtim me dispozitat kushtetuese.

Mbeshtetet unanimisht nga Komisioni.

Pas paraqitjes së amendamenteve të lartcekura dhe debatit në Komision, u nxorr ky:

Përfundim

- I. Miratohen amendamentet e Grupit punues për Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për Akreditim Nr. 02/L-43;
- II. Autorizohet stafi mbështetës për standartizimin juridiko-teknik të amendamenteve të miratuara në Komision;

V. Të ndryshme;**V.1. Caktimi i Grupit punues për shqyrtimin në parim të Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-20 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit;**

Kryetarja – pasiqe njoftoi anëtarët e Komisionit për Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-20 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, kërkoj që të caktohet një Grup punues për shqyrtimin e tij në parim dhe pastaj shqyrtimin e metutujeshëm.

Kryesuejsa konstatoi se Komisioni unanimisht vendosi që të caktohet Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-20 për

Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, në këtë përberje, si më poshtë:

1. Zef Morina – kryesues;
2. Fatmir Rexhepi – anëtar;
3. Et'hem Çeku – anëtar;

V.2. Procesi i Zbatimit të Mbikëqyrjes së Ligjit Nr.2003/11 për Rrugët;

Kryetarja – kërkoj nga Raportuesi i Grupit punues për Procesin i Zbatimit të Mbikëqyrjes së Ligjit Nr.2003/11 për Rrugët, një Vizitë në terren në Rrugën e planifikuar më parë, atë të Dushkajës;

Zef Morina – theksoj se Grupi punues është i pajtimit që më datë 24.07.2008, të behet një Vizitë në Rrugën e Dushkajës dhe poashtu një Takim më udhëheqjen komunale të Gjakovës.

Pas diskutimeve të anëtarve të Komisionit, kryesuesja konstatoi se unanimisht, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- I. Në kuadër të Procesit të Zbatimit të Mbikëqyrjes së Ligjit Nr.2003/11 për Rrugët, Komisioni më datë 24.07.2008, do të realizoj një Vizitë zyrtare në Komunën e Gjakovës dhe do të beje shiqimin e Rrugës së Dushkajës;
- II. Autorizohet Stafi mbeshtetës që ti bëjë të gjitha përgaditjet e duhura për realizimin sa më te suksesshëm të Vizitës;

Mbledhja përfundoi në orën 12:00;

Kryetare e Komisionit:
Myzejene Selmani